



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PREMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**i Qeverisë së Kosovës me
Shoqërinë Civile
(përfaqësuar nga Platforma CiviKos)**

Të përkushtuar për:

- **Ndërtim të demokracisë**, që e çmon aktivitetin e shoqërisë civile dhe e mbështet të drejtën e individit në asociim të lirë me të tjerë, duke e krijuar një mjedis të favorshëm ligjor për veprimin dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile.
- **Qytetari aktive**, duke ju bërë të mundur qytetarëve të marrin pjesë në vendim-marrje;
- **Pluralizëm**, të bazuar në diversitetin e identiteteve dhe të interesave brenda Kosovës, përfshirë edhe grupet e minoriteteve, minoritetet etnike dhe personat me aftësi të kufizuara, duke e mbështetur të drejtën e secilit grup që të shpreh, në emër të vet, interesat e veta;
- **Të drejta të njeriut**, duke inkurajuar respektin për njëri tjetrin si individ, por edhe si pjesëtarë të komunitetit me vlera të përbashkëta;
- **Mundësi të barabarta**, me qëllim të parandalimit të diskriminimit dhe përmirësimit të kushteve dhe rrethanave, për ti dhënë shanse të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë që t'i realizojnë të drejtat që ju takojnë.
- **Transparencë**, që kërkon punë të hapur të institucioneve vendim-marrëse, komunikim dhe llogaridhënie, për luftim të korrupsionit dhe me qëllim të krijimit të kushteve për mirëqenie për të gjithë.
- **Punë ndër-sektoriale**, për të promovuar bashkëpunim ndër-sektorial dhe ndër-ministor më qëllim që t'i përgjigjemi nevojave komplekse të shoqërisë, e që shpesh nuk mund të parcializohen.
- **Zhvillim të qëndrueshëm**, që i plotëson nevojat e tashme, pa ju vështirësuar mundësitë gjeneratave të ardhshme që t'i plotësojnë nevojat e veta.
- **Bashkëpunim** më të mirë të institucioneve publike, qytetarëve dhe shoqatave të tyre.

Dëshirojmë të koordinojmë përpjekjet tona për të realizuar qëllimet e përbashkëta dhe për të vendosur një partneritet gjithëpërfshirës. Me këtë Memorandum, pajtohem që me dispozitat në vijim të rregullojmë bashkëpunimin tonë:

Neni 1 - Qëllimi

Qëllim i këtij Memorandumi është që të vendoset një kuadër për bashkëpunim i Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, që do të rezultojë në

ndërtimin e Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Neni 2 - Definimi i koncepteve

Për nevojat e këtij Memorandumi, konceptet e poshtëshënuara, e kanë kuptimin në vijim:

Koncepti **Qytetar** nënkupton të gjithë individët që jetojnë në Kosovë në mënyrë të ligjshme.

Organizata të shoqërisë civile konsiderohen të gjitha llojet e organizatave të themeluara në bazë të lirisë së asociimit, që nuk janë themeluar me qëllim të përfitimit, si shoqatat, fondacionet, dhe organizatat e tjera të natyrës së ngjashme, që pa marrë parasysh se a janë të regjistruara, apo jo.

Shoqëria civile nënkupton bashkëpunimin e qytetarëve në bazë të iniciativës së lirë, për të realizuar interesat e veta, për të diskutuar çështjet publike dhe për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes, si dhe shoqatat, rrjetet, institucionet, etj. që e mundësojnë një bashkëpunim të këtyllë.

Neni 3 - Partneriteti

Zotimet e qeverisë së Kosovës

Për të inkurajuar ndërtimin e një praktike të mirë dhe metodave të bashkëpunimit në vendim-marrje, Qeveria merr përsipër që:

- Të bashkëpunoj me sektorin e shoqërisë civile për të zhvilluar politikat;
- Të promovojë dialog efektiv, duke e përdorë një plan të përshtatshëm;
- Të bashkëpunojë me sektorin e shoqërisë civile në çështjet që janë preokupim i cilësdo palë, në frymë të hapur dhe të partneritetit;
- Të njohë rolin e CiviKos dhe të organizatave të tjera përfaqësuese të shoqërisë civile në përfaqësimin e pikëpamjeve të anëtarësisë, pa e mohuar të drejtën e organizatave individuale që të përfaqësojnë pikëpamjet e veta;
- Të sigurojë se në procesin e zhvillimit të politikave, do të merret plotësisht parasysh ndikimi që politikat mund të kenë në sektorin e shoqërisë civile dhe në grupet e komuniteteve;
- Të siguroj qytetarët se të gjitha informacionet me të cilat disponon Qeveria janë të hapura për publikun, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe me ligj; dhe
- Të ketë parasysh kufizimet në resurse me të cilat ballafaqohet sektori i shoqërisë civile për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe në partneritet me Qeverinë.

Zotimet e organizatave të shoqërisë civile

Për të bashkëpunuar me Qeverinë, resorët e saj, si dhe me institucionet e tjera publike, sektori i shoqërisë civile merr përsipër që:

- T'i promovojë vlerat e punës në partneritet, në bazë të interesit të anëtarëve të tyre, shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre, dhe publikut të gjerë;
- Të siguroj se do të bëj përpjekje maksimale të mundshme që të informohet një rreth sa më i gjerë i organizatave të shoqërisë civile për bashkëpunimin me qeverinë, për zhvillimin e politikave dhe praktikave që e promovojnë dialogun efektiv;
- Të punojë me Qeverinë në çështjet që e preokupojnë cilëndo palë dhe në frymë të hapur dhe të partneritetit;
- Të sigurojë që përfaqësuesit e vet të jenë të informuar dhe të mbështetur si duhet në të gjitha takimet e partneritetit; dhe
- Të respektoj konfidencialitetin e informacioneve të qeverisë, nëse konfidencialiteti është përcaktuar në përputhshmëri me procedurat ligjore.

Neni 4 - Resurset

Zotimet e qeverisë së Kosovës

Mbështetja financiare e projekteve të organizatave të shoqërisë civile do të bazohet në procedura të qarta të vlerësimit të punës. Qeveria do të:

- Zbatoj çdo herë praktikat më të mira në financim dhe në administrim të granteve, përfshirë pagesën me kohë të fondeve të miratuara;
- Të zbatoj standardet më të mira për monitorimin e punës së financiar nga fondet publike, si dhe të zbatoj dhe të promovoj procedurat e "vlerësimit më të mirë" në mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë, konform kritereve të përcaktuara paraprakisht, të organizatave të shoqërisë civile;
- Ti fokusojë resurset, përfshirë resurset jo-financiare, në mënyrë efektive duke i pasë parasysh edhe ndryshimet e nevojave të shoqërisë;
- Të mbaj dokumentacionin, në mënyrë që të dokumentohet se është marrë në konsideratë ndikimi potencial në sektorin e shoqërisë civile, si pjesë e zhvillimit të politikave; dhe
- Të respektojë konfidencialitetin e informacioneve sensitive komerciale, në përputhshmëri me procedurat ligjore.

Zotimet e shoqërisë civile

Në shfrytëzimin e resurseve publike, sektori i organizatave të shoqërisë civile ndërmerr që të:

- Mbrojë dhe të mbështes rëndësinë e menaxhimit të mirë të resurseve financiare dhe jo-financiare, si dhe të promovoj standardet më të mira të menaxhimit, duke përfshirë përmbushjen e kushteve të mbështetjes me resurse publike;
- Bëj përpjekje për të siguruar "vlerat më të mira" për objektivat e deklaruara me resurset që i përdorë, si dhe të zbatojë dhe të promovojë procedurat e "vlerës më të mirë" në mënyrat që e sigurojnë barazinë e trajtimit të organizatave të shoqërisë civile;
- Bëj monitorimin, vlerësimin e punës, dhe të përgadis dhe paraqes raporte sipas marrëveshjes, për të siguruar shfrytëzimin efektiv të resurseve; dhe
- të pranoj se resurset publike janë të kufizuara, dhe se kontributi i Qeverisë bazohet në prioritetet e përcaktuara me politika.

Neni 5 - Zbatimi

Zotimet e qeverisë së Kosovës

Duke e mbështetur këtë Memorandum, Qeveria e Kosovës, me ndihmën e Ministrive dhe të agjencive të saja, e udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, e merr përsipër që të :

- vendosë plane dhe procedura efektive për të zbatuar këtë memorandum;
- themeloj një kuadër të pranueshëm për të monitoruar dhe për të vlerësuar veprimet e Qeverisë, së bashku me sektorin e shoqërisë civile;
- vendosë mekanizmat për të mundësuar bashkëpunimin ndër-ministror në mënyrë që të ndërtohet Strategjia e Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim me shoqërinë civile.
- promovojë frymën dhe parimet e këtij Memorandumi në të gjithë sektorët e qeverisë, agjencitë e saj dhe në institucionet e tjera publike, përfshirë institucionet publike komunale; dhe
- raportoj rregullisht në progresin e implementimit të memorandumit para CiviKos, Qeverisë dhe publikut të Kosovës në përgjithësi.

Zotimet e shoqërisë civile


Duke e mbështetur këtë Memorandum, organizatat e shoqërisë civile e marrin përsipër që të:

- informojnë një numër sa më të madh të organizatave të shoqërisë civile dhe publikun e gjerë për Memorandumin, të arriturat që shoqëria i përfiton nga Memorandumi dhe obligimet që duhet t'i përmbushë sektori i shoqërisë civile për t'u realizuar memorandumi;
- promovojë frymën dhe parimet e memorandumit në kontaktet me Qeverinë, institucionet publike, përfshirë institucionet publike komunale;
- vendosë një kuadër të duhur, së bashku me institucionet qeveritare për të monitoruar dhe për të vlerësuar zbatimin e Memorandumit; dhe
- raportoj rregullisht për progresin në zbatimin e Memorandumit para organizatave të shoqërisë civile, Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, Qeverisë dhe para publikut të gjerë.

Neni 6 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi


Ky memorandum nënshkruhet sot më datën 09.11.2007, në dy kopje origjinale, hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të të gjitha organizatave të shoqërisë civile, anëtare të CiviKos.

Për Qeverinë e Kosovës



Agim Ceku
Kryeministër

Për CiviKos



Linda Bunjaku
Kryetare e Bordit